



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNALNA UPRAVA OPŠTINE SKENDERAJ  
SKENDERAJ

Nr.  
No. 01-463/01-0055795/23  
Data.  
Data. 01.11.2023



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 2, shkronja d), nenin 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 24 dhe 25 par. 1, 2, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshëm të Komunës, nenin 29 par. 1, 2, 4, 5 dhe 6 si dhe nenin 31 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 84 par. 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, duke u bazuar ne Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, si dhe Harta Zonale e Komunës së Skenderajt 2020-2028, nenin 14 paragrafin 1, 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, sipas vendimit të kuvendit të komunës së Skenderajt për shpalljen të interesit publik Nr.01-463/01-0027465/23, të datës 01.06.2023, Raporti të vlerësimit të MFPT-së (Departamentit të tatimit në pronë) Nr.735-2/2023 të datës 20.09.2023, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën **30.10.2023** miratoi këtë:

## V E N D I M

(Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personave fizik/juridik, **Sabit (Rifat) Kodra** dhe **Merita (Daut) Zabelaj**)

### Neni 1

Miratohet propozim-vendimi me Nr.02-463/01-0053485/23, të datës 16.10.2023, Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personave fizik/juridik, **Sabit (Rifat) Kodra** dhe **Merita (Daut) Zabelaj**.

### Neni 2

Me këtë vendimi, prona e paluajtshme në pronësi të Komunës, ngastra me **Nr.699-2**, me sipërfaqe prej **311m<sup>2</sup>**, të ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme prej **11232m<sup>2</sup>**, Zona Kadastrale Skenderaj;

**KËMBEHET**: Me pronën e paluajtshme në bashkë posedim të **Sabit (Rifat) Kodra** ½, dhe **Merita (Daut) Zabelaj** ½, ngastrën **Nr.583-4**, me sipërfaqe **311m<sup>2</sup>**, Zona Kadastrale Skenderaj.

### Neni 3

Qëllimi i këmbim të pronës së paluajtshme të lartcekur bëhet për interes publikë përkatësisht për realizimin e projektit “**Ndërtimi i Tregut të gjelbër në qytetin e Skenderajt**”

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, nën mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës

### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

**Këtij vendimi i bashkëngjiten:** Vendimi i kuvendit të komunës së Skenderajt për shpalljen të interesit publik me Nr.01-463/01-0027465/23, të datës 01.06.2023, Certifikatat e pronësisë, Kopja e planit, Raporti të vlerësimit të MFPT-së, Dëshmi mbi sigurimin e mjeteve financiare, konfirmimi dhe konstatimi nga Kryetari i Komunës nga DGJKP, dhe Pëlqimi Urbanistikë rreth ndërtimit të Tregut të gjelbër në Komunën e Skenderajt me Nr.06-351/01-0054412/23, i datës 23.10.2023.

**Vendimi i Dërgohet:**

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 DGJKP-së,
- 1x1 DUMA-së,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.

